



Me rastin e Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prizren, me 9 dhjetor 2009

Asambleja e përbërë prej gjyqtarëve vijues: Maria Giuliana Civinini, Guy Van Craen, Angela Kaptein, Anna Bednarek, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Christine Lindemann-Proetel, Dragomir Yordanov, Emilio Gatti, Eija-Liisa Helin, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gerrit-Marc Sprenger, Gianfranco Gallo, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Klaus Huner, Johanna Schokkenbroek, Nikolay Entchev, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Verginia Micheva-Ruseva

Miraton VENDIMIN

Njësëri, për miratimin e kësaj këshille për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatave të Kosovës me rastin e themelimit të sistemit të regjistrimit, vlerësimit dhe të dërgimit të ankesave në lëndët penale në pajtim me nenet 407, 408, dhe 409 Paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

K Ë S H I L L Ë

Për:

- Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Kryetarëve të Gjykatave të Qarkut dhe Komunale të Kosovës

Nga: Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, Komponentit Gjyqësor të EULEX-it

Tema: Këshillë për Gjykatat e Kosovës me rastin e themelimit të sistemit të regjistrimit, vlerësimit dhe të dërgimit të ankesave në lëndët penale në pajtim me nenet 407, 408, dhe 409, Paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Precidency of the
Assembly of EULEX
Judges

Supreme Court of Kosovo

Luan Haradinaj Str.
Police Avenue

P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo

Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



1. Përmbledhje ekzekutive

Siç është paraparë me nenin 3 të Veprimit të përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, kjo ka detyrë që të *“monitoroj, udhëzoj dhe këshilloj institucionet përkatëse të Kosovës në të gjitha fushat e lidhura me sundimin e gjerë të ligjit (përfshirë shërbimin doganor), ndërsa duke mbajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive”*.

Neni 2.4 i Ligjit mbi kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008 (Ligji nr. 03/L-053) parasheh që : *“Përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3,4 dhe 5 të këtij ligjit, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovar për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga EULEX KOSOVË”*.

Në veçanti, këshillimi përbën pikëpamjet formale dhe zyrtare të gjyqtarëve të EULEX-it të marra në mënyrë të përbashkët në Asamblenë e Gjyqtarëve të EULEX dhe të drejtuara autoriteteve vendore gjyqësore, legislative apo të qeverisë në stimulimin e veprimeve të tyre në fushat përkatëse të kompetencës. Me fjalë tjera, këshillimi ka për qëllim të ofroj këshillim profesional autoriteteve kompetente (MD-së, KGJK-së, IGJK-së, Kryetarëve të Gjykatave, Gjykatës Supreme, Parlamentit, Fakulteteve Juridike) në secilën temë të ngritur prej eksperiencës së monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi i ofron aksionarëve (palëve të interesuara) kosovarë mendjehollësi të nevojshme për të intervenuar në ato fusha të sistemit gjyqësor ku nevojitet përmirësim i përgjithshëm dhe struktural që të implementohet për tërë sistemin ligjor dhe që nuk mund të kryhet vetëm me aktivitetin e monitorimit të gjyqtarëve të EULEX-it.

Këshilla e tanishme për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Kryetarëve të Gjykatave të Kosovës mbi themelimin e sistemit të regjistrimit, vlerësimit dhe të dërgimit të ankesave në lëndët penale në pajtim me nenet 407, 408, dhe 409 Paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) paraqet rezultatin e aktiviteteve monitoruese dhe udhëzuese të gjyqtarëve të EULEX-it, në konsultim të afërt me homologët kosovar. Këto aktivitete kanë zbuluar që ekziston mungesë e sistemit harmonik dhe uniform të regjistrimit në lëndët penale. Kjo praktikë nuk është në pajtim me ligjin kosovar dhe të praktikave më të mira evropiane. Këto gjetje paraqesin nevojë urgjente për të ndryshuar praktikën e tanishme, e cila gjithashtu do të mund të ngrite efikasitetin e procedurës ekzekutive në Kosovë.

Precidency of the
Assembly of EULEX
Judges

Supreme Court of Kosovo

Luan Haradinaj Str.
Police Avenue

P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo

Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



2. Parathënie

Sipas nenit 407, gjykatat e shkallës së parë në të cilat janë parashtruar ankesat duhet të vlerësojnë afatin e paraqitjes dhe lejueshmërinë e ankesave. Nëse ato mungojnë, Kryetari i Kolegjit të Gjykatës së Shkallës së Parë me aktvendim duhet ta hedh poshtë ankesën. Pastaj, gjykata e shkallës së parë duhet ti dërgoj një kopje të ankesave palëve kundërshtare dhe të marr përgjigjet e tyre nëse ka ndonjë, në pajtim me nenin 408. Në fund të kësaj procedure, shkresat e lëndës i dërgohen gjykatës së shkallës së dytë për prokurat ankimore. Sipas nenit 409 Paragrafi 1 të KPPK-së, gjykata e shkallës së dytë pas pranimit të shkresave të lëndës me ankesën duhet ti jap shkresat gjyqtarit raportues i cili do ti dërgoj shkresat prokurorit kompetent për shqyrtim, nëse lënda ndiqet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Kryetari i kolegjit duhet të marr parasysht se me qëllim të respektimit të parimit të kohës së arsyeshme siç është paraparë sipas nenit 6 të KEDNJ-së, Prokurorisë duhet dhënë një afat mesatar prej 1 muaji për paraqitjen e mendimit të saj përveç në lëndët veçanërisht komplekse për të cilat Kryetari i Kolegjit mund të lejoj një afat tjetër kohorë.

Në gjetjet nëpërmes Gjyqtarëve të EULEX-it, aktiviteteve të MUK-ut gjatë tërë Gjykatave të Kosovës, është zbuluar se sistemi i regjistrimit të Gjykatave nuk është gjithmonë i saktë në respektimin e kësaj dispozite të ligjit të procedurës. Në të kundërtën, ndonjëherë është vërtetuar se ose ankesat nuk janë vërtetuar për lejueshmëri, apo nuk janë dërguar në mënyrë të saktë, apo gjithashtu shkresat e lëndës së bashku me ankesat menjëherë pas regjistrimit i janë përcjell Prokurorit përkatës, duke mos i dhënë gjyqtarit shkresat apo edhe pa e informuar gjyqtarin lidhur me lëndën. Posaçërisht lidhur me Gjykatën Supreme është praktikë e shpeshtë që gjyqtari mëson lidhur me lëndën vetëm kur Prokuroria kthen shkresat e lëndës me vendimin e saj në Gjykatën Supreme.

3. Situata e tanishme

Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it, pas marrjes së forcës ekzekutive në pajtim me Ligjin mbi kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053), mësoi se si praktikë e regjistrimit shumë gjykata të Kosovës nuk e respektojnë nenin 409 Paragrafi 1 të KPPK-së. Si pasojë paraqitet se shkresat e lëndës së bashku me ankesat nuk janë shqyrtuar për paraqitjen e tyre me kohë apo për lejueshmërinë e tyre, apo të dërguara drejtësisht, apo edhe të dhëna së pari te Prokurori përkatës në vend se ti dërgohen ato gjyqtarit. Respekti i përgjithshëm i procedurës është i një rëndësie të madhe, posaçërisht kur të

Precidency of the
Assembly of EULEX
Judges

Supreme Court of Kosovo

Luan Haradinaj Str.
Police Avenue

P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



merret parasysh aplikimi i neneve 407 dhe 409 në ankesat kundër aktvendimeve.

Në këtë kontekst ekipet e EULEX-it gjithashtu u informuan për problemin e veçantë që në të kaluarën disa shkresa të lëndës kishin mbetur për një kohë të gjatë në zyrën e UNMIK-ut të Prokurorit Publik (ZPPK), dhe të Prokurorive të tjera edhe me vite të tëra. Dështimi i këtyre Prokurorive që me kohë ti kthejnë këto shkresa të lëndëve ka mbetur i pavërejtur pasi që shkrimoret nuk kanë vendosur afate kohore për kthimin e shkresave të lëndës. Përfundimisht, gjyqtarët që kanë fuqi të vendosin afatet dhe të kërkojnë kthimin e këtyre shkresave të lëndës nuk ishin të vetëdijshëm (informuar) për ankesat.

4. Rekomandimet

Ekipet e EULEX-it rekomandojnë që shkrimoret e Gjykatave të Kosovës të ndryshojnë sistemet e tyre regjistruese dhe të përshtaten me dispozitat e neneve 407, 408, dhe 409 Paragrafi 1 të KPPK-së me qëllim të shmangien lëndët e mëtutjeshme nga bartja në shkallë më të lartë të ankesave të cilat do të duhej të hedhen poshtë si të vona apo të palejueshme, e gjithashtu shmangia dërgesave të humbura tek palët legjitime apo në të ardhmen vonesa të tjera të mundshme sikur ato që u përshkruan më lart.

Të kontaktohet dhe bashkëpunohet me Presidencën e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Njësisë së Gjyqtarëve të EULEX-it në nivel të Gjykatës së Qarkut për kërkimin e këshillës dhe përkrahjes në këto çështje. Gjyqtarët e EULEX-it dhe anëtarët e stafit të tyre do të jenë të gatshëm dhe të nderuar për ofrimin e përkrahjes së tyre kolegëve kosovar për këshillim në përmirësimet që do të ishin në të mirë të gjyqësorit kosovar dhe të gjithë njerëzve të Kosovës.

5. Konkluzion

Administrata e gjykatës, e në veçanti shkrimoret e Gjykatave të Kosovës duhet ti përcjellin ligjet e procedurës në mënyrë të duhur dhe efikase.

Nga arsyet e lartpërmendura Asambleja e Tetë e Gjyqtarëve të EULEX-it:

KËSHILLON

Presidency of the
Assembly of EULEX
Judges

Supreme Court of Kosovo

Luan Haradinaj Str.
Police Avenue

P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



Që procedurat e vendosura në nenin 407, 408, dhe 409 të respektohen plotësisht me qëllim të sigurimit të administrimit të duhur dhe efikas të drejtësisë dhe të respektimit të të drejtave të gjitha palëve të përfshira në procedurat penale.

Gjithashtu, që Gjykata Supreme e Kosovës të implementoj sistemin e regjistrimit i cili do të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 409 Paragrafi 1 të KPPK-së.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

**Precedency of the
Assembly of EULEX
Judges**

Supreme Court of Kosovo

Luan Haradinaj Str.
Police Avenue

P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu